



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010) dhe nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për metodologjinë e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale (tekst i spastruar jozyrtar)¹

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale (në tekstin e mëtejme: SVT) të kredive konsumatore të miratuara nga kreditori.

Qëllimi i metodologjisë së llogaritjes SVT është të sigurojë mënyrë unike për llogaritjen e kostove totale të kredisë dhe krahasimin e normave të kostove totale gjatë zgjidhjes së kushteve më të favorshme për përdorimin e kredisë konsumatore.

Shprehjet të cilat përdoren në këtë vendim kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë kredisë konsumatore. Për çdo gjë që nuk përcaktohet me këtë vendim do të aplikohen dispozitat e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë kredisë konsumatore.

2. *SVT është normë skontimi e shprehur në baza vjetore si raport i kostove totale të kredisë me shumën totale të kredisë, me të cilën flukset e skontuara të parasë pas kredisë së miratuar (daljet) janë të barabarta me flukset monetare të skontuara (prurjet) në bazë të shumës totale që e paguan konsumatori.*
3. Kostot totale të kredisë, në këtë vendim, janë të gjitha kostot, përfshirë interesat, provizionet, taksat dhe çfarëdo tarifë tjetër në lidhje me marrëveshjen për kredi konsumatore, të cilat konsumatori duhet t'i paguajë gjatë miratimit dhe shlyerjes së rregullt të kredisë dhe të cilat janë të njohura për kreditorin, përveç kostove noteriale. Kostot e shërbimeve shtesë që lidhen me marrëveshjen e kredisë konsumatore hyjnë në kostot totale të kredisë, nëse përdorimi i

¹ Kjo paraqet tekst të spastruar jozyrtar të Vendimit për metodologjinë e llogaritjes vjetore të kostove totale. Teksti jozyrtar i spastruar i Vendimit për metodologjinë e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale përfshin: Vendimin për metodologjinë e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.91/2011), Vendimi për ndryshime dhe plotësime të Vendimit për metodologjinë e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 152/2011) dhe Vendimi për ndryshime të Vendimit për metodologjinë e llogaritjes së normës vjetore të kostove totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19).

shërbimeve shtesë është i detyrueshëm për miratimin e kredisë ose për miratimin e saj nën kushtet e specifikuara dhe nëse ato janë të njohura për kreditorin.

4. Rrjedhat monetare në bazë të kredisë konsumatore përfaqësojnë të gjitha pagesat në favor të kreditorit (hyrjet për kreditorin) dhe të gjitha pagesat në dobi të konsumatorit (daljet për kreditorin), në bazë të marrëveshjes për kredi konsumatore, të cilat duhet të ndodhin në datë të caktuar. Rrjedha e parasë përfshin të gjitha transfertat e mjeteve të parasë ndërmjet kreditorit dhe konsumatorit, si dhe transfertat e parave me palët e treta, nëse ato transfertat lidhen drejtpërdrejt me miratimin e kredisë, gjegjësisht nëse janë pjesë e kushteve për miratim, përdorimi ose shlyerja e kredisë (për shembull, pagesa e kryegjësë, arkëtimi i provizionit për miratimin e kredisë, tarifa për shërbimin e palës së kreditit, pagesat, tarifa për mbajtjen e llogarisë përmes së cilës regjistrohen arkëtimet dhe pagesat në lidhje me kredinë, kosto të tjera që lidhen me pagesat e mjeteve, pagesat në bazë të shërbimeve shtesë, etj.).

Në transfertat e parave me palë të treta, në këtë vendim nënkuptohen të gjitha rrjedhat monetare nga dhe drejt palëve të treta, të bëra në llogari të konsumatorit (pagesa e këstit nga një palë e tretë në llogari të konsumatorit, transferimi i mjeteve të kredisë te pala e tretë në llogari të konsumatorit etj.)

5. Kur bankë ose kursimore - kreditori miraton kredi konsumatore të siguruar me depozitë në para, gjatë llogaritjes së SVT-së, banka gjegjësisht kursimorja është e detyruar ta përfshijë në llogaritje dhe ndikimin e hyrjeve dhe daljeve të skontuara të parasë bazuar në atë depozitë.
6. Gjatë skontimit të flukseve monetare, zbatohet numri aktual (kalendarik) i ditëve në muajin dhe 365/366 ditë në vit.

SVT shprehet me dy dhjetore, me rrumbullakim të dhjetorit të dytë.

II. METODOLOGJIA E LLOGARITJES SVT

7. Metodologjia e llogaritjes SVT përfshin:

- përgatitja e Pasqyrës së flukseve monetare;
- mënyra e llogaritjes së SVT-së dhe
- kumtimi para informacioneve kontraktuale.

8. *SVT llogaritet në bazë të kushteve të kreditimit që ekzistojnë gjatë lidhjes së marrëveshjes për kredi konsumatore.*

Gjatë llogaritjes së SVT-së, kreditori nuk përfshin shumën e kostove që nuk e ka të njohur, por është i detyruar ta deklarojë qartë në pasqyrën e rrjedhës së parasë nga kreu III i këtij vendimi dhe në formularin nga pika 16 e këtij vendimi dhe në të njëjtën kohë t'i përshkruajë këto kosto.

III. PASQYRA E RRJEDHJES SË PARAVE PËR NEVOJAT E LLOGARITJES SË SVT-SË

9. Gjatë themelimit të marrëdhënies së kredisë, kreditori është i detyruar të përgatisë pasqyrë të flukseve monetare me SVT të shprehur qartë dhe t'ia dorëzojë konsumatorit. Pasqyra e flukseve monetare (formulari 1) është pjesë përbërëse e dosjes së kredisë së konsumatorit.

Formulari 1 është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

10. Kreditori është i detyruar të sigurojë dokument se konsumatorit i është dorëzuar pasqyrë e flukseve monetare dhe se ai është i njohur me kushtet e marrëveshjes për kredi konsumatore, përfshirë SVT-në. Ky dokument është pjesë përbërëse e dosjes së kredisë së konsumatorit.
11. Pasqyra e flukseve monetare përgatitet në bazë të normës së interesit kontraktual dhe nën supozimin e ekzekutimit të rregullt të të gjitha transaksioneve (flukseve të parasë), të parashikuara me marrëveshjen për kredi konsumatore.

Kreditori është i detyruar, në pasqyrën e rrjedhës së parasë të shënojë normën e interesit kontraktuale, duke vënë në dukje nëse ajo është fikse apo e ndryshueshme. Nëse në marrëveshjen e kredisë konsumatore është përcaktuar periudha në të cilën norma e interesit do të jetë fikse dhe periudha gjatë së cilës ajo do të jetë e ndryshueshme, ato periudha duhet të deklarohen detyrimisht në Pasqyrën e rrjedhave të parasë.

12. Kreditë konsumatore në valutë (kreditë e miratuara në valutë), në pasqyrën e rrjedhës së parasë, shprehen në valutën në të cilën është lidhur marrëveshja për kredi konsumatore.

Kreditë konsumatore me klauzolë valutore shprehen në denarë në Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë, me zbatimin e kursit të këmbimit që është i vlefshëm në ditën e lidhjes së marrëveshjes për kredi konsumatore, gjegjësisht në ditën e përgatitjes së pasqyrës së rrjedhës së parasë (Pasqyra e rrjedhës së parasë për nevojat e llogaritjes së SVT-së përgatitet në ditën e lidhjes së marrëveshjes). Kursi i aplikuar i këmbimit duhet të deklarohet detyrimisht në Pasqyrën e Flukseve të Parasë.

Nëse kreditori, në përputhje me marrëveshjen, përdor disa kurse këmbimi gjatë miratimit dhe arkëtimit (kursi i blerjes ose shitjes së bankës, kursi i mesëm i BPRM-së, etj.), në Pasqyrën e flukseve të parasë, duhet të shprehen të gjitha kurset e përdorura që janë të vlefshme në ditën e përgatitjes së pasqyrës të flukseve monetare, duke vënë në dukje se për çfarë është përdorur secila prej atyre kurseve.

Me përjashtim nga paragrafi 2 i kësaj pike, kreditë konsumatore në denarë me klauzolë devizore mund të shprehen në valutë, nëse gjatë pagesës dhe arkëtimit të kredisë përdoret i njëjti kurs i këmbimit (p.sh. kursi i mesëm i Bankës Popullore).

Për llogaritjen e SVT-së për kreditë në valutë, ku provizionet dhe tarifat llogariten dhe arkëtohen në denarë, kreditori duhet t'i konvertojë ato në valutë duke aplikuar kursin mesatar të këmbimit të Bankës Popullore, i cili vlen në ditën e përgatitjes së Pasqyrës të flukseve të parasë.

13. Përveç asaj që parashikohet në këtë kapitull dhe në kreun IV të këtij vendimi, Pasqyra e flukseve monetare duhet të përmbajë edhe kostot nga pika 14 nënpika zh, pika 2 i këtij vendimi, si dhe emri dhe adresa e kreditorit, lartësia e SVT-së dhe data në të cilën është llogaritur dhe nënshkrimi i personit përgjegjës në kreditorin.

III. MËNYRA E LLOGARITJES SË SVT-SË

14. *SVT-ja llogaritet në bazë të Pasqyrës së Flukseve të Parasë nga pika 9 e këtij vendimi, i cili plotësohet duke zbatuar rregullat e mëposhtme:*

a) Në kolonën nr. 1 „Numri rendor“, shënohet numri rendor i datës në të cilën duhet të

ndodhë fluks i caktuar parash. Numri rendor 0 (zero) tregon datën në të cilën është realizuar fluksi i parë i parasë (arkëtimi i provizionit, kreditimi i miratuar, etj.). Numri i fundit rendor i referohet datës në të cilën do të bëhet fluksi i fundit i parasë;

b) Në kolonën nr. 2 „Data rrjedhëse e parasë”, shënohet data në të cilën duhet të realizohet rrjedhja e caktuar e parasë. Për llogaritjen e drejtë të SVT-së, tek kreditë që do të tërhiqen në këste, kreditori duhet t’i kërkojë konsumatorit të tregojë datat e planifikuara të tërheqjes së kësteve.;

c) Në kolonën nr. 3 “Pagesa e kredisë”, shënohet shuma e kredisë, gjegjësisht pjesa e kredisë (kësti) i cili duhet të paguajë kreditori, në datën e shënuar në kolonën nr. 2;

ç) Në kolonën nr. 4 „Pagesa tjera”, shënohen të gjitha pagesat tjera të mundshme që kreditori duhet t’i kryejë në bazë të marrëveshjes për kredi konsumatore, përveç pagesave në bazë të depozitës së parave që shërben si sigurim i kredisë – nëse kreditori është bankë ose kursimore;

d) Në kolonën nr. 5 “Këstet”, shënohet shuma e kësteve (anuitetet) që konsumatori është i detyruar t’i paguajë në datat përkatëse të maturimit. Në pasqyrën e flukseve monetare, është e detyrueshme të shënohet nga cilat elemente përbëhet kësti;

dh) Në kolonën nr. 6 “Pagesa”, shënohet shuma e kryegjësë që është pjesë nga kësti përkatës;

e) Në kolonën nr. 7 “Interesi”, shënohet shuma e interesit që është pjesë e këstit përkatës, si dhe shuma e interesit interkalar;

ë) Në kolonën nr. 8 „Tarifa tjera”, shënohen të gjitha tarifat tjera, gjegjësisht arkëtimet që konsumatori duhet t’i kryejë në bazë të marrëveshjes për kredi konsumatore. Si arkëtime tjera konsiderohen të gjitha arkëtimet që drejtpërdrejt janë të lidhura me kushtet për përdorimin e kredisë konsumatore, përfshirë edhe shërbimet shtesë të detyrueshme, që bien në ngarkesë të konsumatorit dhe që hyjnë në llogarinë SVZ, siç janë:

- provizioni për përpunimin e kërkesës për kredi;
- provizioni për miratimin e kredisë;
- provizioni për administrimin e kredisë (udhëheqjen, dërgimin e certifikatës dhe të ngjashme);
- provizioni për ruajtjen e instrumentit për sigurim (pengu);
- provizionet dhe tarifat që lidhen me përdorimin e shërbimeve shtesë të detyrueshme në lidhje me kredinë konsumatore;
- kosto tjera, provizione dhe tarifa që janë të detyrueshme dhe drejtpërdrejt të lidhura me kredinë.

Në llogarinë e SVT nuk përfshihen:

- kostot që lidhen me mospërbushjen ose përbushjen në kohë të detyrimeve të marrëveshjes për kredi konsumatore;
- kostot, me përjashtim të çmimit të blerjes, që i paguan konsumatori gjatë blerjes së mallrave ose përdorimit të shërbimit, pavarësisht nëse pagesa është bërë me para të gatshme ose me kredi;
- shërbime noteriale;

f) Në kolonën nr. 9 „Gjendja e kredisë”, shënohet mbetja e kredisë që duhet ta kthejë konsumatori, e cila fitohet kur gjendja e kredisë nga data e mëparshme (rendi i mëparshëm nga kolona nr. 9) do të zvogëlohet për shumën e pjesës së arkëtuar nga kryegjësja (kolona nr. 6) në datën e caktuar dhe do të rritet për shumën e kredisë së arkëtuar (kolona nr. 3) në datën e caktuar;

Të gjitha shumat në kolonat numër 3 deri numër 9 shënohen me shenjë pozitive, pa dallim a bëhet fjalë për prurje ose dalje të parasë.

g) Në kolonën nr. 10 "Fluksi i parasë në bazë të sigurimit (depozitë)", shënohen flukset e parasë në bazë të depozitave të parasë të investuar nga konsumatori, që përdoret si sigurim i kredisë konsumatore i miratuar nga banka ose kursimorja: arkëtimi dhe pagesa e depozitit, interesi i depozitit, kosto të mundshme në lidhje me depozitin e parasë dhe të ngjashme. Prurjet shënohen me shenjë pozitive, ndërsa daljet me shenjë negative;

gj) Në kolonën nr. 11 "Përshkrimi", shënohet përshkrim i shkurtër i fluksit të parasë në datën e caktuar;

h) Kolona nr. 12 „Fluksi i parasë neto”, paraqet dallimin ndërmjet përmbledhjes nga prurjet e parasë në bazë të kryegjësë së kthyer (kolona nr. 6), interesi i arkëtuar (kolona nr. 7) dhe pagesa tjera (kolona nr. 8) dhe përmbledhjen nga daljet e parave në bazë të kredisë së paguar (kolona nr. 3) dhe pagesa tjera (kolona nr. 4). Fluksi i parasë neto mund të jetë me shenjë pozitive ose negative, ku shenja pozitive paraqet prurje neto të mjeteve për kreditorin, ndërsa shenja negative nënkupton dalje neto të mjeteve nga kreditori i datës së caktuar;

Në kolonën nr. 13 "Fluks monetar neto të skontuar ", shënohet shuma e fluksit monetar të skontuar nga kolona nr. 12. Skontimi kryhet me përdorimin e SVT, që llogaritet në pajtim me formulën në vijim:

$$\text{HPIIT}_{\kappa} \left(1 + \frac{\text{CBT}}{100} \right)^{-\frac{\pi}{\tau}}, \text{ ku}$$

FMN_{κ} – fluksi monetar neto për datën κ (kolona nr. 12);

SVT - norma e kostove totale, me të cilën kryhet skontimi i flukseve monetare neto, ku shuma e flukseve monetare të skontuara është e barabartë me zero. SVT konsiderohet kur elementet tjera të formulës janë të njohura, nga përgjigjja ose në mënyrë tjetër;

$\frac{\pi}{\tau}$ – paraqet numër të ditëve nga data 0 deri në datën κ , të shprehur në vite.

SVT paraqet zgjidhje aproksimative në formulën në vijim:

$$\sum_k \left[\text{HPIIT}_{\kappa} \left(1 + \frac{\text{CBT}}{100} \right)^{-\frac{\pi}{\tau}} \right] = 0$$

$\frac{\pi}{\tau}$ fitohet si përmbledhje nga tre komponentët në vijim

- numri i ditëve nga data zero deri më 31.12. në vitin zero në raport me numrin total të ditëve në vit të cilës i përket data zero;
- - numri i viteve nga viti i datës zero deri në vitin në të cilin ndodhet fluksi i parasë i cili skontohej (κ), ku nuk merren parasysh këto dy vite;

numri i ditëve prej 31.12. në vitin paraprak ($\kappa - 1$) deri në datën e fluksi monetar $\text{dat}(\kappa)$, në raport të numrit të ditëve në vit në të cilën gjendet fluksi monetar e cila skontohej (κ), gjegjësisht

$$\frac{D}{T} = \left[\frac{\Gamma\Gamma\Gamma(0)31.12 - \text{дат}(0)}{T(0)} \right] + [\Gamma\Gamma\Gamma(\kappa) - \Gamma\Gamma\Gamma(0) - 1] + \left[\frac{\text{дат}(\kappa) - \Gamma\Gamma\Gamma(\kappa - 1)31.12}{T(\kappa)} \right]$$

ku,

$T_0 = 1 + \Gamma\Gamma\Gamma(0)31.12 - \Gamma\Gamma\Gamma(0)01.01$ – numri i ditëve në vitin zero (365/366); $T_\kappa = 1 + \Gamma\Gamma\Gamma(\kappa)31.12 - \Gamma\Gamma\Gamma(\kappa)01.01$ – numri i ditëve në vit ku gjendet fluksi monetar (365/366);

dat(0) është data e datës zero,
dat(κ) është data e fluksit monetar që skontohe.

Tek kreditë konsumatore që sigurohen me depozitë në para (kredi të miratuara ekskluzivisht nga bankat dhe kursimoret), SVT-ja e llogaritur rregullohet në mënyrë shtesë për hyrjet dhe daljet e skontuara bazuar në atë depozitë, nëpërmjet formulës së mëposhtme:

$$\text{CBT}_{\text{прилаго дена}} = \text{CBT} \times \frac{\text{ВДИК}}{\text{ВДИК} - \text{ВДТО}}$$

ku,

ВДИК është shuma totale e pagesës së skontuar të kredisë, e llogaritur në pajtim me nënpikën l) të kësaj pike; derisa

ВДТО është shuma totale e fluksit monetar të skontuar të sigurimit të llogaritur në pajtim me nënpikën m) të kësaj pike.

i) Në kolonën nr. 14 "Pagesa e kredisë së skontuar", shënohet shuma e skontuar e kredisë konsumatore të paguar për datën κ . Skontimi bëhet me përdorimin e SVT të konfirmuar me ndihmën e formulës në vijim:

$$\text{ДИК}_\kappa = \left[(\text{ИК}_\kappa) \left(1 + \frac{\text{CBT}}{100} \right)^{\frac{D}{T}} \right], \text{ ku}$$

ДИК_κ - pagesa e skontuar e kredisë për datën κ ;
 ИК_κ – pagesa e kredisë për datën κ (kolona nr. 3).

Shuma totale e skontuar e pagesës së kredisë (ВДИК) fitohet si përmbledhje nga të gjitha pagesat e posaçme të skontuara të kredisë (rendi "Gjithsej" për kolonën nr. 14)

$$\text{ВДИК} = \sum_{\kappa} \text{ДИК}_\kappa$$

j) Në kolonën nr. 15 "Fluksi monetar i skontuar i sigurimit", shënohet shuma e skontuar e fluksit monetar në bazë të sigurimit (depoziti i parasë i investuar nga konsumatori i miratuar ekskluzivisht nga banka ose kursimorja). Skontimi kryhet me përdorimin e SVT të konfirmuar me ndihmën e formulës në vijim:

$$\Delta TO_{\kappa} = \left[(TO_{\kappa}) \left(1 + \frac{CBT}{100} \right)^{-\frac{\Delta}{T}} \right], \text{ ku}$$

FSS_{κ} – fluksi skontuar i sigurimit të datës κ ;

FS_{κ} – fluksi monetar i sigurimit (depoziti i parasë) për datën κ (kolona nr. 10).

Shuma totale e fluksit monetar të skontuar të sigurimit (SHTFMSS) paraqet përmbledhje të të gjitha flukseve të skontuara të sigurimit (rendi „Total” për kolonën nr. 15)

$$SHTFMSS = \sum_{\kappa} \Delta TO_{\kappa}$$

15. *SVT*, *SVT* e rregulluar dhe kolonat ndihmëse numër 12, 13, 14 dhe 15 janë element i detyrueshëm i Pasqyrës së flukseve monetare.

Me përjashtim, koloat ndihmëse numër 12, 13, 14 dhe 15 nuk duhet të përmbahen në Pasqyrën e flukseve monetare që dorëzohet tek konsumatori.

Tek kreditë konsumatore kornizë, tek të cilat për çdo tërheqje të mjeteve lidhet marrëveshje e veçantë kredie, me të cilën janë rënë dakord për kushtet e kredisë, kreditori përgatit pasqyrë të posaçme të flukseve monetare me deklaratë të SVT.

Nëse nuk është e mundur të llogaritet SVT (nuk është e mundur të parashikohen datat dhe shumat e flukseve të parave - për shembull në rastin e kredive të bazuara në kartela krediti, mbitërheqje dhe mbitërheqje të lejuara, etj.), kreditori është i detyruar ta njoftojë konsumatorin për të gjitha llojet e kostove që ai detyrohet t'i paguajë, duke përfshirë edhe normën e interesit.

IV. KUMTIMI I INFORMACIONIT TË PARAKONTRAKTUAR

16. Para se të lidhë marrëveshje për kredi konsumatore, kreditori ose ndërmjetësi i kredisë është i detyruar t'i japë konsumatorit formular me informacione parakontraktore për kushtet e kredisë së ofruar, në fomrë me shkrim ose në medie tjetër të qëndrueshme.

Formën dhe përmbajtjen e formularit nga kjo pikë e përcakton guvernatori me udhëzim të posaçëm.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

17. Dispozitat e këtij vendimi nuk zbatohen për marrëveshjet e kredisë konsumatore të cilat janë të lidhura para fillimit të zbatimit të tij.

Dispozitat e këtij vendimi që i referohen kreditorit i referohen edhe ndërmjetësit të kredisë.

18. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi pushon të vlejë Vendimi për metodologjinë për llogaritjen e normës vjetore të kostove totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 105/2007 dhe 42/2011).

19. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet nga 01.10.2011.

**Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов**